



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 47, Datë 23.05.2022

MONITORIM I ZBATIMIT TË KONTRATËS SI REZULTAT I INDICIEVE NGA
ORGANET AUDITUESE

Autoriteti kontraktor	DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL SHKODËR
Organi auditues	AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA
Numri i kontratave të audituara	5 (pesë)
Konstatimet kryesore	<p>1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1, të nenit 24, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, (në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës), lidhur me ngurtësimin e sigurimit të kontratës.</p> <p>2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1 dhe 3, të nenit 77, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, (në fuqi në kohën e lidhjes së 2 kontratave) si dhe pikës 7, të nenit 107, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, (në fuqi në kohën e lidhjes së 3 kontratave), përse i përket dokumentacionit që lidhet me zbatimin e kontratës, i cili nuk është administruar dhe verifikuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, si dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për trajtimin e problematikës së shfaqur gjatë zbatimit të kontratës.</p> <p>3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 3, të nenit 6, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe pikën 5, të nenit 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, lidhur me dërgimin e formularit të njoftimit të kontratës së nënshkruar, brenda 5 (pesë) ditëve, pranë organit qendror blerës. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dërguar ftesë për ofertë</p>

	operatorit ekonomik fitues, për lidhjen e kontratës bazuar në marrëveshjen kuadër, sipas pikës 10.2, të Udhëzimit të APP Nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.
Masat e marra	Në bazë të neneve 23, gërma “e”, dhe 132, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj personave të ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratave, si dhe personit përgjegjës për prokurimin, të evidentuar përgjegjës për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim.